



Udhëzues Metodologjik

Titulli i projektit: “**Environmental Justice in Albania**”

Numri i referencës: **IPA III/2023/452-010**

Pozicioni i punës: Ekspert i për realizimin e kërkimeve në sektorin publik, “për shqyrtimin e kundërvajtjeve të natyrës administrative me karakter mjedisor”

Vendndodhja: **Në nivel kombëtar (institucione dhe agjenci të pushtetit qendror)**

Kohëzgjatja: **Produkti final deri më 31/05/2025**

Afati përfundimtar: **28/03/2025**

1. Konteksti

Mbrojtja e mjedisit mbetet një sfidë e rëndësishme në Shqipëri, e cila dikton nevojën për ndërhyrje të përmirësuara në nivelin administrativ dhe ekzekutiv. Pavarësisht vëmendjes së shtuar që ka marrë mjedisi dekadën e fundit, për shkak të disa zhvillimeve ligjore negative lidhur me projektet zhvillimore në zonat e mbrojtura apo sjelljen e teknologjive të vjetëruara dhe ndotëse për prodhim energjie, duket se tendencat më të fundit fundit derregulluese në rang global, kanë filluar të depërtojnë edhe në sferën legislative dhe ekzekutive shqiptare.

Megjithatë, shumë institucione shtetërore dhe agjenci ekzekutive me përgjegjësi mbikëqyrëse e kanë pjesë të kompetencave të tyre dhënien e dënimeve administrative. Këto dënime marrin kryesisht formën e gjobave, të heqjes së licensave për përdorim apo shfrytëzim, ose penalitete të natyrave të tjera ndëshkuese financiare dhe jo-financiare, për shkeljet që lidhen me dëmtimin e mjedisit, natyrës ose biodiversitetit. Gjithsesi, evidentojmë mungesën e një tabloje të përgjithshme të ndjekjes së këtyre kundërvajtjeve, si dhe të adresimit apo ndëshkueshmërisë së tyre përmes instancave përgjegjëse. Një tjetër element i rëndësishëm për t’u eksploruar në kuadër të kësaj detyre është edhe të njohurit më saktë se cilat janë organet me përgjegjësi për ndjekjen ose ndëshkimin e kundërvajtjeve të natyrës administrative, si dhe organet që janë më të angazhuara në këtë drejtim.

Në këto kushte mbetet e nevojshme një analizë e plotë e mënyrës sesi këto kundërvajtje janë identifikuar, administruar dhe zbatuar. Ky dokument përcakton termat e referencës për angazhimin e një eksperti që do të realizojë këtë analizë.

2. Rreth Projektit

Projekti “EJA: Environmental Justice in Albania”, i financuar nga Bashkimi Evropian, synon të përmirësojë aksesin në drejtësinë mjedisore në Shqipëri, duke rritur kapacitetet ligjore dhe gjyqësore dhe duke forcuar pjesëmarrjen publike. Një produkt kyç i këtij projekti është Raporti “Green Justice and Grey Crime in Albania”, i cili do të analizojë gjendjen aktuale të drejtësisë mjedisore në Shqipëri, do të identifikojë hendeqet dhe do të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësim.



Në këtë kontekst, për të adresuar më së miri sa më sipër, REC Shqipëri dhe partnerët kanë autorizuar ngritjen e një trupe ekspertize nën udhëheqjen e Kryesuesit të Grupeve të Punës, i mbikëqyrur dhe në konsultim të drejtpërdrejtë me ekipin zbatues të projektit. Trupa e ekspertizës ka në përbërje grupe ekspertësh të cilët kanë një angazhim të posaçëm me njërin prej tri fushave (Policia, Gjykatat dhe Prokuroritë) me përgjegjësi në gjurmimin dhe analizën e paligjshmërive mjedisore. Eksperti ose grupi i përzgjedhur i ekspertizës në kuadër të kësaj thirrjeje do të duhet të bashkërendojnë punën e tyre kërkimore dhe raportimin me proceset e punës së këtij grupi.

Raporti përfundimtar do të përbëhet nga disa kapituj, secili duke u fokusuar në aspekte të ndryshme të drejtësisë mjedisore. Këta kapituj do të zhvillohen nga grupe ekspertësh të specializuar, të cilët punojnë në fusha të ndryshme, duke përfshirë:

- **Kapitulli Policisë: Roli i Policisë në Drejtësinë Mjedisore në Shqipëri**
Grupi i Ekspertëve për Kapitullin e Policisë do të analizojë rolin e agjencive të zbatimit të ligjit në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Studimi do të fokusohet në punën e Policisë së Shtetit, duke filluar nga viti 2015.
Analiza synon të thellohet në mënyrën se si këto institucione parandalojnë dhe hetojnë krimet mjedisore, si dhe bashkëpunojnë me ekspertët mjedisorë. Studimi do të shqyrtojë rastet e regjistruara, metodat e përdorura dhe efektivitetin e ndërhyrjeve policore, duke u bazuar në të dhënat nga institucionet dhe agjencitë përkatëse.
- **Kapitulli i Prokurorisë: Roli i Prokurorisë në Drejtësinë Mjedisore në Shqipëri**
Grupi i Ekspertëve për Kapitullin e Prokurorisë do të studiojë rolin e prokurorisë në trajtimin e çështjeve mjedisore që nga viti 2009. Studimi do të përqendrohet në analizimin e procedurave penale, mbledhjen e të dhënave dhe identifikimin e llojeve të ndryshme të krimeve mjedisore në Shqipëri.
Analiza do të përfshijë shqyrtimin e mënyrës se si prokuroria regjistron, heton dhe procedon rastet mjedisore, duke përfshirë mbledhjen e provave, caktimin e ekspertëve dhe ndjekjen e çështjeve në gjykatë..
- **Kapitulli i Gjyqësorit: Roli i Gjykatave në Drejtësinë Mjedisore në Shqipëri**
Grupi i Ekspertëve për Kapitullin Gjyqësor do të kryejë shqyrtimin e hollësishëm të çështjeve mjedisore në gjykatat shqiptare për periudhën 2013-2023. Ky shqyrtim merr parasysh të dhënat e kufizuara historike dhe ndryshimet e fundit në Kodin Penal, veçanërisht ato të sjella nga Ligji 44/2019, që kanë futur vepra të reja penale mjedisore. Fokusi i studimit do të jetë në institucionet kryesore gjyqësore, ndërkohë që metodologjia do të përfshijë konsultimin e sistemeve elektronike, dokumentacionit gjyqësor dhe kryerjen e takimeve me autoritetet përkatëse.

Përveç këtyre grupeve, do të jetë edhe një kapitull për median, që do të hartohet nga partnerët tanë, BIRN Albania, si dhe analiza që është në objektin e detyrës së përvijuar në këto terma reference. Drejtuesi i Ekipit do të jetë përgjegjës për të koordinuar punën e grupeve të ekspertëve, duke siguruar që raporti përfundimtar të jetë koherent dhe i plotë, dhe të përfshijë kontributet e të gjitha grupeve.

3. Qëllimi i Angazhimit

Eksperti ose grupi i ekspertizës i ngarkuar me këtë detyrë do të angazhohet për të kryer:

(1) Hartëzimin e organeve ekzekutive me përgjegjësi për inspektimin, vlerësimin dhe lëshimin e ndëshkimeve në rast konstatimi të një kundërvajtjeje administrative. Krahas hartëzimit, duhet shqyrtuar dhe puna reale që kryejnë këto organe dhe cili ka qenë niveli i angazhimit të tyre në administrimin e masave përkatëse.

(2) Vlerësimin në vetvete të kundërvajtjeve administrative të konstatuara nga institucione/organe të ndryshme shtetërore për shkelje të standardeve që cenojnë mjedisin, natyrën dhe biodiversitetin, duke analizuar kuadrin ligjor dhe mënyrën e zbatimit të tij. Gjithashtu, interes në këtë pikë do të përbënte dhe kategorizimi i formave të ndëshkimit (p.sh., gjobë, heqje license, masë tjetër ndëshkuese, paralajmërim, etj.), atëherë kur diçka e tillë është e mundur. Për më tepër, nëse e lejon mundësia, një vlerësim i kombinuar cilësor dhe sasior do të ishte i pëlqyeshëm.

Objektivi përfundimtar i procesit të punës: Në përfundim të punës, eksperti ose grupi i përzgjedhur ekspertizës do të duhet t'i sintetizojë gjetjet e tij në një kapitull të posaçëm të raportit të titulluar "Cap & Gap" - ky i fundit, si pjesë e diagnostikës tërësore që po i bëhet drejtësisë mjedisore në vendin tonë në të gjitha hallkat institucionale.

4. Objektivat Specifikë

Eksperti ose grupi i përzgjedhur i ekspertizës do të duhet:

- Të identifikojë institucionet shtetërore dhe ekzekutive që kanë lëshuar dënime administrative (gjoba, penalitete, masa detyruese) për shkeljet që shoqërohen me pasoja në mjedis, natyrë dhe biodiversitet;
- Të hartojë një analizë të bazës ligjore për këto kundërvajtje administrative;
- Të vlerësojë nivelin e zbatimit të këtyre masave dhe efektivitetin e tyre për periudhën kohore të përcaktuar;
- Të identifikojë praktikat më të mira dhe boshllëqet në sistemin e dënimeve administrative për çështje mjedisore;
- Të ofrojë rekomandime që mund të çojnë në përmirësimin e procedurave administrative dhe forcimin e mekanizmave të zbatimit.

5. Fusha e Veprimit

Eksperti ose grupi i përzgjedhur i ekspertizës do të analizojë periudhën nga viti 2020 e në vijim, duke u fokusuar në:

- Legjislacionin në fuqi mbi kundërvajtjet administrative;
- Numrin dhe tipologjinë e gjobave dhe dënimeve të vendosura nga institucionet përgjegjëse;
- Institucionet përgjegjëse, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Agjencinë Kombëtare të

Zonave të Mbrojtura (AKZM), Agjencitë Rajonale të Mjedisit, si dhe ministritë përkatëse¹.

6. Metodologjia

Eksperti ose grupi i përzgjedhur i ekspertizës pritet të përdorë metodologji të ndryshme kërkimore, duke përfshirë:

- Analizën e legjislacionit kombëtar (dhe evropian) mbi kundërvajtjet administrative për çështjet mjedisore;
- Shqyrtimin dhe mbledhjen e të dhënave nga institucionet publike dhe/ose raportet zyrtare, gjithmonë konform dispozitave të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe referuar tij në shkresa dhe procedura zyrtare;
- Angazhimin me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe ekspertë të fushës;
- Bashkërendimin e punës me anëtarët e tjerë të ekipeve të ekspertizës në kuadër të projektit “EJA”, nën udhëheqjen e Kryesuesit të Grupeve të Punës (Team Leader);
- Analizën e rasteve studimore për të vlerësuar efektivitetin e dënimeve administrative.

7. Produktet e Pritshme

Eksperti ose grupi i përzgjedhur i ekspertizës do të duhet të dorëzojë produktet e mëposhtme:

- Një raport fillestar mbi metodologjinë e përdorur dhe burimet e informacionit;
- Një analizë të detajuar të kundërvajtjeve administrative të dhëna nga institucionet për shkeljet mjedisore;
- Një raport përfundimtar që përfshin gjetjet kryesore dhe rekomandime për përmirësimin e kuadrit administrativ dhe zbatimin e tij.
- Integrimi i gjetjeve në kapitullin e posaçëm të raportit “‘Cap & Gap’: From Grey Crime to Green Justice”, në kuadër të projektit “EJA”, si dhe bashkërendimi i punës me ekspertët përgjegjës për kapitujt e tjerë të projektit.
- Prezantimi i gjetjeve dhe përfaqësimi i projektit, sipas nevojës që mund të lindë në aktivitete të tjera – në koordinim me ekipin e projektit.

8. Produktet, Kohëzgjatja dhe Afatet

Eksperti ose grupi i përzgjedhur i ekspertizës do të angazhohet për një periudhë prej 2 muajsh, duke ndjekur këto afate kryesore:

- **Javët 1-3:** Mbledhja e të dhënave dhe analiza paraprake;
- **Javët 4-5:** Takime/intervista dhe përpunimi i informacionit;
- **Javët 5-8:** Finalizimi i raportit dhe paraqitja e rekomandimeve.

9. Kriteret për Përzgjedhjen e Ekspertit

Kandidatët duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

¹ Megjithatë, lista e mësipërme nuk është shteruese. Eksperti i përzgjedhur do të duhet të propozojë edhe institucione të tjera me përgjegjësi për marrjen e masave administrative.



- Diplomë në drejtësi, shkenca mjedisore, administrim publik ose fusha të ngjashme;
- Eksperiencë 2-5 vjeçare në analizën e çështjeve administrative dhe/ose mjedisore;
- Njohuri të thelluara mbi kuadrin ligjor për mbrojtjen e mjedisit dhe kundërvajtjet administrative në Shqipëri;
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe raportimi.

10. Strukturat Mbështetëse dhe Burimet

Eksperti ose grupi i përzgjedhur i ekspertizës do të bashkëpunojë ngushtë me ekipin e projektit, ekipet e tjera të ekspertizës që pritet të ngrihen në kuadër të këtij projekti, si dhe institucionet relevante për të siguruar qasje në të dhëna dhe informacione të nevojshme për realizimin e detyrës.

11. Raportimi dhe Mbikëqyrja

Eksperti ose grupi i përzgjedhur i ekspertizës do të raportojë rregullisht mbi progresin e punës tek ekipi i projektit dhe do të marrë udhëzime për përmirësime të mëtejshme sipas nevojës.

12. Dokumentet e Aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme gjatë fazës së aplikimit:

- CV – Duke përfshirë përvojën profesionale dhe arsimore relevante.
- Letër Interesi – Përshkrim i shkurtër mbi përvojën përkatëse dhe motivimin për këtë angazhim.
- Qasja Teknike (2-3 faqe) – Përshkrimi i metodologjisë së propozuar për realizimin e detyrës.
- Raporte/Analiza me fokus të ngjashëm.

13. Procesi i Përzgjedhjes

Kandidatët do të vlerësohen bazuar në:

- Përshtatshmërinë e formimit akademik.
- Thellësinë e përvojës relevante.
- Cilësinë e punës së mëparshme.
- Aftësinë për të punuar në një ekip ndërdisiplinor.

14. Konsideratat Etike

Eksperti ose anëtarët e grupit të përzgjedhur të ekspertizës do të duhet t'u përmbahen standardeve etike të REC Albania, duke përfshirë:

- Respektimin e komuniteteve lokale dhe ndjeshmërisë kulturore.
- Angazhimin për barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale.
- Respektimin e politikave për Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual (PSEA).